



Mësoj rreth
fëmijës

Kalimi nga kopshti në fillore

Shkolla fillore ka kërkesa të ndryshme dhe mënyrë tjetër funksionimi nga ato të kopshtit. Për këtë nevojitet një procedurë e re përshtatjeje nga ana e fëmijës por dhe e prindërve.

Çfarë mund të bëjnë prindërit për të lehtësuar këtë procedurë?

- Tregojnë gëzim që fëmija e tyre u rrit dhe do të shkojë në shkollë.
- Përgatitin bashkë me fëmijën ambientin dhe sendet që do të nevojitet për të mësuar.
- Përgatitin dhe zbatojnë një program fiks ditor për fëmijën (p.sh. orën e gjumit, mënyrën e të shkuarit nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas).
- Tregojnë besim tek fëmija i tyre. Theksojnë vazhdimisht se janë të sigurtë se ai/ajo do t'ia dalë mbanë.
- Bëjnë bashkë me fëmijën një vizitë paraprake për t'u njohur me ambientin e shkollës dhe mësuesin/ mësuesen.
- Bisedojnë me mësuesin/ mësuesen për vështirësitë e mundshme të fëmijës ose dhe të tyre për sa i përket gjuhës apo dhe temave të tjera.

- Nëse vështirësohen me gjuhën, përdorin dikë të afërm apo ndonjë shok/shoqe (dhe jo fëmijën), që t'i ndihmojë ata në komunikimin me mësuesin /mësuesen.
- Shoqërojnë fëmijën ditën e parë të vitit shkollor dhe shkëmbejnë përshtypjet e tyre gjatë ditës dhe në fund të saj. Kushtojnë kohë për këtë – është një ditë shumë e rëndësishme për fëmijën e tyre!
- Përpiqen të afrojnë fëmijën e tyre me fëmijët e tjerë të shkollës ose të klasës së tij/saj.
- I flasin pozitivisht, por dhe realisht për mësuesin /mësuesen dhe fëmijët e tjerë (p.sh. «të qortoi, por e bëri sepse të do»).
- E përgatisin për realitetin shkollor duke i folur me realizëm për të, por pa e trembur. Nuk theksojnë kërkesat, por elementët pozitivë (p.sh. do të mësojë gjëra të reja, do të mund të lexojë vetë përrallat, do të ketë shokë/ shoqe që të luajë).
- Tregojnë interes për gjithçka që ndodh në shkollë dhe për gjithçka që mëson fëmija. E pyesin në përgjithësi nëse kaloi mirë, por i bëjnë pyetje edhe më konkrete, si p.sh. «për çfarë folët sot?», «çfarë të pëlqeu më shumë?»
- E lavdërojnë për sukseset e tij/saj ndërkohë që i quajnë të natyrshme disa mosuksese apo vështirësi që ai /ajo has në shkollë.
- E inkurajojnë të përgatisë vetë detyrat e shkollës dhe çantën e tij/saj.

Pasi kanë folur me mësuesin/ mësuesen do të ishte mirë që prindërit të këshillohen me ndonjë specialist (p.sh. psikolog) kur:

- Për një kohë të gjatë fëmija i tyre refuzon me insistim të shkojë në shkollë, shfaq ndjenja frike të theksuara ose shqetësime fizike.
- Prindërit vështirësohen të përballojnë çdo vështirësi të fëmijës.
- Fëmija nuk mund t'u përgjigjet kërkesave mësimore.
- Fëmija paraqet vështirësi në marrëdhëniet e tij/saj me fëmijët e tjerë, p.sh. është i vetmuar apo shumë agresiv.
- Fëmija nuk përqëndrohet dot në detyrat e shkollës.



Enti zbatues

POLIDHROMOS: Grupi dhe Botimi periodik për Dytshkollë dhe Shumëkulturrën në Arsim dhe në Shoqëri



www.polydromo.gr
polydromo@polydromo.gr

Autore teksti

Anthula Kontopulu

Departamenti i Shkencave të Edukimit
dhe të Arsimit Parashkollor
Universiteti Aristoteli Selanik

Koordinatorë të programit

Birbili Maria – Cokalidhu Rula

Departamenti i Shkencave të Edukimit
dhe të Arsimit Parashkollor
Universiteti Aristoteli Selanik

Email: mmpirmpi@nured.auth.gr
tsokalid@nured.auth.gr

Website: www.polydromo.gr/dialogos/

Përkthyes

Valbona Hystuna

Përpunuan tekstin

Evi Marku

Me mbështetjen e